

ÇFARË ËSHTË PATENTA ?

Patenta është një e drejtë ligjore ekskluzive që jepet për një shpikje. Shpikja është një produkt ose proces që siguron një mënyrë të re për të bërë diçka ose ofron një zgjidhje të re teknike për një problem.

ÇFARË OFRON PATENTA ?

Patenta i ofron mbajtësit të saj mbrojtje ligjore për një shpikje. Mbrojtja jepet për një afat të përcaktuar prej 20 vjetësh, nëse çdo vit paguhen tarifatat e përtëritjes për mbajtjen e patentës në fuqi.


Ç' LLOJ MBROJTJEJE OFRON PATENTA ?

Mbrojtja me patentë do të thotë se një shpikje nuk mund të hidhet në treg, të përdoret, shpërndahet apo të shitet pa miratimin e pronarit të patentës. Këto të drejta mbi patentën zbatohen nga gjykata, e cila ka autoritetin të ndalojë shkeljen e patentës.



CILAT JANË TË DREJTAT E PRONARIT TË PATENTËS ?

Pronari i patentës ka të drejtën të vendosë se kush mund ta përdorë ose jo shpikjen e patentuar për periudhën gjatë së cilës mbrohet shpikja. Pronari i patentës mund t'iu japë autorizim ose licencë palëve të tjera për përdorimin e shpikjes, në bazë të kushteve për të cilat është rënë dakord në mënyrë të ndërsjellë. Gjithashtu, pronari mund t'ia shesë shpikjen dikujt tjetër, i cili, më pas, bëhet pronari i ri i patentës. Me skadimin e afatit të patentës, përfundon edhe mbrojtja dhe shpikja bëhet e vlefshme për përdorim publik. Kjo nënkupton se pronari nuk ka më të drejta ekskluzive mbi shpikjen, e cila bëhet e vlefshme për t'iu shfrytëzuar për qëllime tregtare nga të tjerët.



PËRSE JANË TË NEVOJSHME PATENTAT?

Patentat iu ofrojnë stimuj individëve, duke iu siguruar vlerësim për krijimtarinë e tyre dhe shpërblim financiar për shpikjet e tyre të tregtueshme. Këta stimuj nxisin inovacionin, i cili siguron rritjen në vazhdimësi të cilësisë së jetës së njeriut.

Ç' ROL LUAJNË PATENTAT NË JETËN E PËRDITSHME ?

Është fakt që shpikjet e patentuara kanë hyrë në çdo aspekt të jetës së njeriut, që prej ndriçimit elektrik (patentim i bërë nga Edison dhe Swani) dhe plastikës (patentim i bërë Baekeland), deri te stilolapsat me majë sferike (patentat mbahen nga Biro) dhe mikroprocesorët (patentat mbahen nga Intel).

Të gjithë pronarët e patentës duhet të bëjnë publik informacionin mbi shpikjen e tyre, në mënyrë që të pasurojnë trupën tërësore të njohurive teknike në botë. Kjo trupë e njohurive publike, që është gjithnjë në rritje, nxit krijimtarinë e mëtejshme dhe novatorizmin të tjerët. Në këtë mënyrë, patentat ofrojnë informacion të vlefshëm e frymëzim për brezat e ardhshëm të studiuesve dhe shpikësve.

SI MERRET PATENTA ?

Duhet ndërmarrë hapat procedural në vijim:

- 1) Paraqitja e kërkesës për patentë, që përmban:
 - * Formulari i kërkesës për dhënie patente,
 - * Përshkrimi i shpikjes,
 - * Pretendimet që përcaktojnë shtirjen e mbrojtjes,
 - * Vizatimet, nëse është e nevojshme,
 - * Përmbledhje e shkurtër e shpikjes,
 - * Dëshminë për pagesën e tarifës,
 - * Autorizimin (nëse paraqitësi i aplikacionit nuk e ka selinë në vend),
 - * Çertifikata e prioritetit, nëse ka një aplikim të huaj të mëparshëm,

- 2) Ekzaminimi dhe pagesa e tarifave,
- 3) Patentimi dhe publikimi pas 18 muajve,
- 4) Pagesa e tarifës vjetore,
- 4) Prova patentueshmërie brenda 10 vjetëve.



CILAT SHPIKJE MUND TË MBROHEN ?

Shpikja duhet të përmbushë kriteret vijuese, në mënyrë që të mbrohet nga patenta:

- * Të jetë e zbatueshme në industri përgjithërisht dhe bujqësinë;
- * Ajo duhet të përbëjë risi; domethënë nuk është pjesë e njohurive të mëparshme. Arritja e mëparshme përfshin çdo njohuri ekzistuese të fushës teknike përkatëse që i është bërë e njohur publikut.
- * Shpikja duhet të përfshijë një hap shpikës, i cili nuk mund të rezultojë nga përshtypja e një individi me njohuri mesatare në atë fushë.
- * Së fundi, lënda e saj duhet të lejojë përcaktimin si “e patentueshme”. Zbulimet, teoritë shkencore, metodat matematikore, varietetet bimore dhe shtazore ose metodat për trajtimin e organizmit të njeriut apo kafshëve, që zbatohen drejtpërdrejt në këtë organizëm, nuk janë të patentueshme.

KUSH I LËSHON PATENTAT ?

Patentat lëshohen nga Agjencia e Pronësisë Industriale (API), pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

CILA ËSHTË BAZA LIGJORE ?

- * Ligji nr. 04/L-029 për Patenta
- * Ligji nr. 05/L-039 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-029 për Patenta
- * Udhëzimi Administrativ Nr. 13/2016 për Procedurat e Regjistrimit të Patentave
- * Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2016 për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale

SA KUSHTON NJË PATENTË ?

Tarifat për marrjen e një patente përfshijnë *tarifat zyrtare; shih Udhëzimi Administrativ Nr. 10/2016 për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale

FAQE INTERNETI

www.mti.rks-gov.net

www.kipa.rks-gov.net

KONTAKT

Agjencia e Pronësisë Industriale
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Rr. "Muharrem Fejza", p.n, Lagja e Spitalit,
10000- Prishtinë, Kosovë
Telefon: +381 38 200 36554

ÇFARË ËSHTË PATENTA ?

Çfarë duhet të dini ...



Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Agjencia e Pronësisë Industriale
Rr. Muharrem Fejza, 10000, Prishtinë
+381 38 200 36 554